



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.** **Tiranë** ___/___/2020

Nr. Dok.

Lënda: *Rekomandohet bashkërendimi i punës për të përditësuar të dhënat që merren nëpërmjet shërbimit elektronik e-Albania.*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË GJENDJES CIVILE
Tiranë

AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT
Tiranë

Për dijeni: DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE
Tiranë

Të nderuar,

Në letërkëmbimin e mëparshëm që kemi patur jeni njohur me hetimin administrativ të nisur nga Institucioni i Avokatit të Popullit lidhur me ankesat e dy të dënuarve, I. L. dhe E. K., të cilët pretendonin se nuk ishin transferuar në një burg më afër vendbanimit të familjes, Tirana. I. L. vuan të dënimin në IEVP Fier ndërsa E. K. në IEVP Malësi e Madhe.

Për verifikimin e dy ankesave jemi interesuar fillimisht në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale përkatëse ku të dënuarit vuan të dënimin si dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Kjo e fundit është shprehur se, vendbanimi i të dënuarve I. L. dhe E. K. nuk është në Tiranë, por respektivisht në Fier dhe në Pukë. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve e ka siguruar këtë informacion nëpërmjet shërbimit elektronik e-Albania. Në certifikatat personale të gjeneruara nga ky portal rezulton se, vendbanimi i E. K. është Puka dhe vendbanimi i I. L. është

Fieri. Për këtë arsye kërkesa e të dënuarve për t'u transferuar në një IEVP më afër vendbanimit të familjes është konsideruar si e pabazuar dhe ndaj është refuzuar¹.

Në kuadër të hetimit administrativ, një veprim i kryer nga ana jonë ishte dhe administrimi i vendimeve penale të gjykatës për dy të dënuarit në të cilat evidentuam se ishte shënuar se, I. L. dhe E. K. janë banues në Tiranë. Në këto rrethana, iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile duke kërkuar të informoheshim për vendbanimin aktual të dy shtetasve dhe nëse ishin përditësuar të dhënat e certifikatave që gjeneron portali e-albania.al. Në përgjigjen e dërguar nga ky institucion u vumë në dijeni se:

“pas verifikimeve të kryera në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 rezulton se:

- *Shtetasi I. L., rezulton të jetë i regjistruar, banor në zyrën e gjendjes civile në Njësinë Bashkiake Nr.9, Njësia Administrative Tiranë, Bashkia Tiranë, me adresë vendbanimi: Rruga “Mine Peza”, pall.210, shk.4, ap.20, Tiranë;*
- *Shtetasi E. K., rezulton të jetë i regjistruar, banor në zyrën e gjendjes civile në Bashkinë Pukë, me adresë vendbanimi : Rruga “Buhot”, nr.14, Pukë,*

të dhënat, të cilat nuk rezultojnë në përmbajtje të dokumentave elektronike, të gjeneruar nga platforma qeveritare e-albania, edhe pse këto të dhëna i vihen në dispozicion AKSHI-t nga Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile.”

Në vijim, iu drejtua Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për të marrë shpjegime lidhur me arsyen e mos përditësimit të të dhënave në certifikatën e shtetasit I. L. Në përgjigjen që kemi marrë, e cila i dërgohet për dijeni Ministrin të Brendshëm, Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Brendshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, informohemi si vijon:

“Bazuar në VKM Nr.673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar, AKSHI është institucioni përgjegjës për ofrimin e shërbimeve publike në portalin qeveritar e-Albania. Portali e-Albania shërben si një mjet i sigurtë transmetimi i të dhënave midis qytetarëve dhe institucioneve të administratës publike për përfitimin e sigurt të dokumenteve administrative të ofruara nga ato. Aktualisht, portali qeveritar

¹Në Ligjin Nr.8328, datë 16.4.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", neni 66 "Rregullat e transferimit", paragrafi i dytë parashikohet se:

"Transferimet duhet të favorizojnë mundësi që të dënuarit ta kryejnë dënimin pranë vendbanimeve të familjeve të tyre".

Ndërsa në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve parashikohet si më poshtë:

Neni 65 "Kërkesa për transferim", pika 1,

"Kërkesa për transferim mund të paraqitet nga i paraburgosuri dhe i dënuari ose familjarët e tij, për arsye shëndetësore, familjare, shkaqe që kanë të bëjnë me formimin profesional, kur i rrezikohet jeta ose shëndeti, si dhe për shkak të afërsisë me vendbanimin e familjarëve të tij."

Neni 66 "Shqyrtimi i kërkesës për transferim", pika ç,

"kur kërkesa për transferim bazohet në shkaqe familjare, të formimit profesional, si dhe në afërsinë me vendbanimin e familjarëve të tij, sektori i kujdesit social përgatit një raport të arsyetuar dhe të hollësishëm, ku jepen të dhëna për gjendjen familjare, vendbanimin e familjarëve të të paraburgosurit apo të dënuarit, gjendjen sociale, arsimore dhe profesionale të tij, si dhe për referencat zyrtare të ardhura nga institucionet e tjera shtetërore, të cilat vërtetojnë shkakun familjar, të vendbanimit të familjarëve, si dhe formimin profesional.

e-Albania ofron rreth 600 shërbime elektronike për qytetarët, bizneset dhe nëpunësit e administratës publike. Ky portal funksionon nëpërmjet Platformës Qeveritare të Ndërveprimit, në të cilën ndërveprojnë 50 sisteme të cilat shkëmbejnë të dhëna në kohë reale.

Procedura e përfitimit të dokumentave administrative elektronike në portalin e-Albania kryhet përmes aplikimit që i adresohet institucionit, i cili administron bazën e të dhënave shtetërore prej së cilës gjenerohet edhe dokumenti administrativ elektronik. Ky dokument pasqyron të gjitha të dhënat që ndodhen në bazën e të dhënave shtetërore të institucionit që i administron ato. Ndarja mes sistemit informatik dhe regjistrit të të dhënave, është shprehur dhe reflektuar qartazi në pikën 6/y të VKM Nr.673, datë 22.11.2017 të sipërpërmendur.

AKSHI “administron nga ana teknike sistemin informatik të institucioneve të përmendur në shkronjën “i”, të pikës 6, në përputhje me parashikimet e këtij vendimi. Regjistrat e të dhënave të këtyre institucioneve që përbëhen nga bazat e të dhënave mbeten nën administrim të institucioneve respektive”.

Në këtë kuadër, AKSHI mundëson përmes portalit e-Albania vetëm shkëmbimin e të dhënave, të bazave të të dhënave shtetërore përmes platformës qeveritare të ndërveprimit në kohë reale dhe pa të drejtë përpunimi për shpërndarjen e të dhënave tek qytetari si marrës i këtyre të dhënave.

Referuar rasteve konkrete të përcjella nga ana juaj, rezulton se është përdorur shërbimi “certifikatë personale” për të verifikuar vendbanimin aktual të personave. Certifikata personale është një dokument administrativ i lëshuar nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile nën administrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Në momentin e gjenerimit të certifikatës personale në portalin e-Albania, të dhënat e shfaqura në certifikatën personale plotësohen më ndërveprim nga të dhënat që mban kopja e bazës së të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile. Aktualisht webservice-t që përdoren në portalin e-Albania dhe nga çdo bazë tjetër të dhënash shtetërore që ndërvepron me bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile janë të ekspozuara në një server jashtë infrastrukturës mbështetëse ku është instaluar dhe kopja e bazës së të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile.

*Çdo ndryshim që realizohet në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, duhet të reflektohet dhe në kopjen e bazës së të dhënave në serverin ku janë të ekspozuara webservice-t nga ku konsumohen të dhënat nga palët e treta. **Përditësimi i këtyre të dhënave bëhet manualisht nga punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, por nuk realizohet brenda një afati kohor të përcaktuar.***

Mungesa e reflektimit të ndryshimeve në kohë reale ka sjellë ankesa të shumta nga qytetarët që përdorin portalin e-Albania për gjenerimin e dokumentave me vulë elektronike dhe me vlerë të plotë ligjore. Duke u nisur pikërisht nga rëndësia e këtij regjistri elektronik që është bazë të dhënash shtetërore, nga ku lëshohen dokumentet më të rëndësishëm administrative, si dhe duke u nisur nga efekti që kanë probleme të tilla të përsëritura te qytetarët apo vetë administrata publike, kemi përcjellë kërkesa të vazhdueshme pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për zgjidhjen e kësaj problematike. Zgjidhja e problematikës konsiston në kalimin në ambientin live të webservice-ve të ekspozuara nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile që

aktualisht ndodhen në një ambient test. Ky proces duhet të realizohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile në mënyrë që të shmangen problematika të tilla të përsëritura”.

Qytetarët janë informuar vazhdimisht në median vizive dhe elektronike që t’i drejtohen portalit e-Albania për të marrë shërbime më të shpejta nga institucionet shtetërore. Ky shërbim në formë elektronike mund të kërkohet jo vetëm nga personat fizikë, por edhe nga personat juridikë (institucione publike dhe biznese). Personat e interesuar ftohen të përdorin këtë portal, si një mënyrë e shpejtë dhe e sigurtë për të marrë shërbimin e kërkuar.

Referuar VKM Nr. 673, datë 22.11.2017 “*Për organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*”, i ndryshuar, pika 6/k, kjo Agjenci administron portalin unik qeveritar e-Albania, platforma qeveritare e ndërveprimit për ofrimin e shërbimeve të qeverisjes elektronike. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit është institucion publik qendror, në varësi të Kryeministrit (pika I/1 e VKM-së). AKSHI është Autoriteti Rregullator Kordinues i të dhënave shtetërore i përcaktuar me VKM në zbatim të Ligjit Nr. 10 325, datë 23.9.2010 “*Për bazat e të dhënave shtetërore*” (neni 9). Çdo institucion që ofron shërbim elektronik nëpërmjet portalit e-Albania duhet të zbatojë rregullat e përcaktuara në VKM Nr.495, datë 13.09.2017 “*Për miratimin e rregullave të përfuturit të shërbimeve publike elektronike*”.

Nga analizimi i akteve normative si Ligji Nr. 10 325, datë 23.9.2010, VKM Nr. 673, datë 22.11.2017, VKM Nr.495, datë 13.09.2017 dhe sqarimi që bëhet në faqen zyrtare e-Albania, në rubrikën “rreth portalit”, rezulton se të dhënat që shfaqen në portal përditësohen nga vetë institucionet e administratës që ofrojnë shërbime nëpërmjet portalit. AKSHI administron sistemin informatik të institucioneve dhe organeve të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, sikurse përmendet në pikën 6/i të VKM-së. Ndërsa secili institucion administron të dhënat që ka objekt të punës së tij sipas përcaktimit të nenit 3/a të Ligjit Nr. 10 325, datë 23.9.2010² dhe pikës 6/y të VKM Nr. 673, datë 22.11.2017.³

Pra, në rastin konkret, përditësimi i të dhënave në sistemin kompjuterik për vendbanimin e të dënuarit duhet të ishte kryer nga punonjësit e Zyrës së Gjendjes Civile, në mënyrë që të pasqyroheshin në certifikatën personale të gjeneruar në mënyrë elektronike. Mungesa e përditësimit ka sjellë si pasojë që të dënuarit *I. L.* t’i refuzohet kërkesa për t’u transferuar e për të vuajtur dënimin në një Institucion të Ekzekutimit të Vendimeve Penale më afër vendbanimit të familjes, si një nga të drejtat e garantuara në ligjin për të drejtat e të dënuarve dhe të paraburgosurve.

² Në nenin 3/a të Ligjit Nr. 10 325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore” parashikohet:

“Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Baza e të dhënave shtetërore” kuptohet grumbullimi i organizuar i informacionit, i ruajtur në formë elektronike, ku përpunimi dhe përditësimi i tij kryhen nëpërmjet një sistemi kompjuterik, si pjesë e plotësimit të detyrimeve ligjore të institucionit administruar”.

³ Në pikën 6/y të VKM Nr. 673, datë 22.11.2017 “Për organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar parashikohet se AKSHI:

y) Administron nga ana teknike sistemin informatik të institucioneve të përmendura në shkronjën “i”, të pikës 6, në përputhje me parashikimet e këtij vendimi. Regjistrat e të dhënave të këtyre institucioneve që përbëhen nga bazat e të dhënave mbeten nën administrim të institucioneve respektive”.

Nga ana tjetër, vlerësojmë se AKSHI luan rolin kryesor në zbatimin e politikave në fushën e teknologjisë, koordinimin e të dhënave shtetërore dhe organizimin e strukturës për ofrimin e shërbimeve publike elektronike. Ndaj, për të siguruar një shërbim sa më cilësor dhe përmbushur detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni, jo vetëm Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, në rastin konkret të trajtuar nga ana jonë, por edhe institucionet që administrojnë të dhëna duhet të bashkëpunojnë me AKSHI-n (neni 12/1 i Ligjit Nr. 10 325, datë 23.9.2010), proces i cili duhet të realizohet në vijimësi.

Regjistri elektronik si një bazë të dhënash shtetërore, nga ku lëshohen dokumente administrative, merr një rëndësi të veçantë në realizimin e interesave apo shërbimeve publike nga qytetarët, bizneset apo vetë administrata publike. Duke u nisur nga efektet apo problematikat që mund të sjellin tek subjektet e interesuar mungesa e reflektimit të ndryshimeve në kohë reale apo përditësimi i të dhënave, çmojmë se është e nevojshme marrja e masave nga institucionet e sipërpërmendura për koordinimin e punës dhe bashkëpunimin ndërmjet tyre për të ofruar një shërbim në kohë të shpejtë dhe cilësor. Vërtetësia dhe saktësia e të dhënave të regjistrit të gjendjes civile është një çështje për të cilën legjislatori ka parashikuar detyrim të veçantë komunikimi nga ana e shtetasve e madje ka parashikuar edhe dënim me gjobë, në rast të mospërditesimit të këtyre të dhënave. Kjo tregon rëndësinë shumë të madhe që ka për shtetin mbajtja e të dhënave të sakta. Megjithatë ende në vend mbetet problem saktësia e të dhënave të këtyre regjistrave për shkak të neglizhencës së qytetareve, ndërkohë që mosfunksionimi i një mekanizmi efektiv për përditësimin e të dhënave të portalit E-Albania është krejtësisht i pa justifikuar.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut”* si dhe në mbështetje të nenit 21/b të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”*

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile për bashkërendimin e punës me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për të përditësuar të dhënat që merren nëpërmjet shërbimit elektronik e-Albania në funksion të ofrimit të një shërbimi efektiv, cilësor dhe kohë të shpejtë ndaj subjekteve të interesuar.

- Analizimin e këtij rasti nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, për të shërbyer si një praktikë për rritjen e bashkëpunimit në një nivel më të lartë me të gjithë institucionet që ofrojnë shërbime elektronike nëpërmjet portalit e-Albania.

Për qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi dhe masat që do të merrni për zbatimin e tij, na vini në dijeni brenda një afati kohor të përshtatshëm.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi

Përgatiti: Adil Skuqi, Ndhmëskomisioner